FEDERATA ESPORTS KOSOVA

FEDERATA ESPORTS KOSOVA – FESK BORDI I FEDERATËS

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Bordit të Federatës Esports Kosova

Data: 29.03.2026
Vendi: Prishtinë
Mbledhjen e udhëhoqi: Kryetari i FESK-së, Altin Preniqi

Procesmbajtës: Driton Mehmeti

Të pranishëm:

1. Altin Preniqi – Kryetar i FESK-së
2. Valon Bllacaku – Anëtar i Bordit
3. Arben Sllovinja – Anëtar i Bordit
4. Jeton Sopiani – Anëtar i Bordit
5. Fatos Binaku– Anëtar i Bordit

Të ftuar/propozues:
Dardan Makoilloi, Ymer Mehmeti dhe Faton Polisi.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i nevojës për funksionalizimin e Komisionit Disiplinor të Federatës Esports Kosova;
2. Shqyrtimi i propozimit për përbërjen e re të Komisionit Disiplinor;
3. Të ndryshme.

PIKA 1

Shqyrtimi i nevojës për rizgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit Disiplinor

Kryetari i FESK-së, Altin Preniqi, hapi mbledhjen dhe paraqiti nevojën për funksionalizimin e organeve të Federatës, në veçanti të organit përgjegjës për trajtimin e çështjeve disiplinore.

U theksua se, në përputhje me Statutin e Federatës Esports Kosova dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Sport, është e nevojshme që Federata të ketë të funksionalizuar organin disiplinor, i cili do të shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë disiplinore të sportistëve, klubeve, zyrtarëve dhe subjekteve tjera që veprojnë në kuadër të FESK-së, sipas kompetencave të përcaktuara me Statut dhe aktet përkatëse.

Anëtarët e Bordit diskutuan lidhur me rëndësinë e funksionalizimit të këtij organi dhe u pajtuan se funksionalizimi Komisionit Disiplinor është i nevojshëm për funksionimin e rregullt të Federatës dhe për zbatimin e dispozitave statutare dhe rregulloreve të FESK-së.

PIKA 2

Shqyrtimi i propozimit për përbërjen e Komisionit Disiplinor

Pas diskutimit, u paraqit propozimi që Komisionit Disiplinor i FESK-së të përbëhet nga tre (3) anëtarë:

1. Dardan Makolli– Kryesues;
2. Ymer Mehmeti – Anëtar;
3. Faton Polisi– Anëtar.

Anëtarët e Bordit të FESK-së diskutuan lidhur me propozimin dhe, pas shqyrtimit të tij, u pajtuan që Komisioni Disiplinor të formohet në përbërjen e propozuar.

Pas përfundimit të diskutimit, Bordi i Federatës Esports Kosova, në pajtim me kompetencat e përcaktuara me Statut, vendosi të miratojë propozimin për rizgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Për këtë çështje u miratua vendimi i datë 29.03.2026, për formimin e Komisionit Disiplinor të Federatës Esports Kosova.

PIKA 3

Të ndryshme

Nën pikën "Të ndryshme", anëtarët e Bordit diskutuan për çështje të tjera që lidhen me funksionimin dhe aktivitetet e Federatës.
Pas përfundimit të pikave të rendit të ditës dhe pasi nuk pati çështje të tjera për diskutim, Kryetari e shpalli mbledhjen të përfunduar.

Kryetari i FESK-së
Altin Preniqi